



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 116-3622 /2025

Klinë, datë 04/02/2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, më datën 04.06.2008, nr.28, dispozitat e nenit 21 të Ligjit, nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, dispozitat e Rregullores së QRK-së për Procedurat e Punës në Tryezat Multidisiplinare për Ndhimë në Menaxhimin e Rastit, si dhe dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, Kryetari i Komunës së Klinës, mori **këtë**;

V E N D I M

Për themelimin e Tryezës Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit

1. **THMELOHET**, Tryeza Multidisiplinare për Ndhimë në Menaxhimin e Rastit në Komunën e Klinës.
2. Tryeza Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit, ka këtë përbërje:
 - 2.1. Menaxheri i rastit nga Qendra për Punë Sociale;
 - 2.2. Ndhimës menaxheri i rastit nga QPS;
 - 2.3. Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë të Viktimave - Mbrojtësi i Viktimave;
 - 2.4. Shërbimi Sprovues i Kosovës - Zyrtari i Shërbimit Sprovues;
 - 2.5. Qendra e Mjekësisë Familjare – mjekë specialistë sipas specifikave të rastit;
 - 2.6. Policia e Kosovës;
 - 2.7. Qendra për Shëndet Mendor – specialist i fushës për trajtimin e fëmijëve;
 - 2.8. Drejtoria Komunale për Arsim - Zyrtar për Arsim;
 - 2.9. Drejtoria Komunale për Mirëqenie Sociale – Zyrtari përgjegjës;
 - 2.10. Psikologu/Punëtori, Social/Pedagogu i Shkollës ose përfaqësues i deleguar nga institucioni edukativo-arsimor;
 - 2.11. Zyra Komunale për Komunitete - Zyrtari për Komunitet;
 - 2.12. Institucioni për Strehim Përkujdesjes ose familja strehuese;
 - 2.13. Zyra Komunale për të Drejtat e Njeriut - Zyrtari për të Drejtat e Njeriut/Fëmijës;
 - 2.14. Përfaqësues të Organizatave Joqeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijës.
3. Tryeza Multidisiplinare është nën udhëheqjen e menaxherit të rastit ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - 3.1. Trajton rastet specifike të abuzimit, keqtrajtimit të fëmijës dhe lënien pas dore në bazë të interesit më të mirë të fëmijës;
 - 3.2. Përcjell dhe në vazhdimësi rishqyrton vlerësimin e rastit të bërë paraprakisht nga menaxheri i rastit, duke e plotësuar me informata të përditësuara varësisht nga ndryshimi i gjendjes së fëmijës apo rrethanave në rast;
 - 3.3. Bashkërendon dhe zhvillon procesin e planifikimit të përbashkët të veprimit për mbrojtje të fëmijës në përputhje me rrethanat dhe me legjislacionin përkatës në fuqi;
 - 3.4. Koordinon ofrimin e shërbimeve për mbrojtje, rehabilitim, dhe integrim apo riintegrim të fëmijës, në mënyrë të qëndrueshme dhe përkrah familjet e tyre ose kujdestarin;

- 3.5. Rishikon planin individual për mbrojtjen e fëmijës në baza mujore, në raste specifike edhe më shpesh;
- 3.6. Harton raportin vjetor për punën e vet dhe raporton tek Komuna dhe sipas kërkesës edhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit për të Drejtat e Fëmijës.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Përgjegjësit e institucioneve/zyrave si nga pika 1;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.

